



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 62, datë 16.06.2022

PËR

MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË TABELËS SË DETAJIMIT TË FONDIT, BASHKALIDHUR VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 40, DATË 09.05.2022 “PËR MIRATIMIN E DETAJIMIT TË FONDIT PREJ 2’303’173’480 LEKË PA TVSH NË ZBATIM TË VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.181, DATË 30.03.2022 “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RIFORCIMIT TË NJËSIVE INDIVIDUALE TË BANIMIT DHE NJËSIVE TË BANIMIT NË NDËRTESA (PALLAT), NË BASHKITË TIRANË, DURRËS, SHIJAK, LEZHË DHE KRUIJË”, PËR SHKAK TË NJË GABIMI MATERIAL

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr.68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.181, datë 30.03.2022 “Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e riforcimit të njësive individuale të banimit dhe njësive të banimit në ndërtësa (pallat), në bashkitë Tiranë, Durrës, Shijak, Lezhë dhe Krujë”, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 40, datë 09.05.2022 “Për miratimin e detajimit të fondit prej 2.303.173.480 lekë pa tvsh në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.181, datë 30.03.2022 “Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e riforcimit të njësive individuale të banimit dhe njësive të banimit në ndërtësa (pallat), në bashkitë Tiranë, Durrës, Shijak, Lezhë dhe Krujë”, si dhe sipas relacionit të hartuar nga Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria e Projekteve dhe Infrastrukturës Publike, me propozim të Kryetares së Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Miratimin e ndryshimit të tabelës së detajimit të fondit, bashkëlidhur Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 40, datë 09.05.2022 “Për miratimin e detajimit të fondit prej 2.303.173.480 lekë pa tvsh në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.181, datë 30.03.2022 “Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rforcimit të njësive individuale të banimit dhe njësive të banimit në ndërtësa (pallat), në bashkitë Tiranë, Durrës, Shijak, Lezhë dhe Krujë”, për shkak të një gabimi material, sipas tabelës bashkëlidhur, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi, Drejtoria e Buxhetit, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Sektori i Prokurimeve dhe Drejtoria e Projekteve dhe Infrastrukturës Publike, Bashkia Durrës

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi





U shpall sot me datë 17.06.2022

TABELA E NDRYSHUAR E DETAJIMIT TË FONDIT

Emërtimi i projektit	Fondi në lekë
Riforcimi pallateve me kod gis: 20590,22363,20402,19065,19659, 21258,21167,47053,38766,19068, 21281,22369 riforcimi i baneses individuale në njësinë administrative Manëz të Xhelal Sefa.	412,792,063
Mbikqyrje	5,647,868
Kolaudim	619,637
Riforcimi pallateve me kod gis: 25759,25583,22842,22243,22248, 22866,24812,22707,25248,22721, 24821,22245,22299	428,636,839
Mbikqyrje	5,871,351
Kolaudim	641,265
Riforcimi pallateve me kod gis: 5407,25387,26969,1511,25947, 26972,27307,26764	417,302,520
Mbikqyrje	5,113,769
Kolaudim	567,950
Riforcimi pallateve me kod gis: 24, 5703, 5414, 6169, 94, 80, 99	503,102,130
Mbikqyrje	6,240,198
Kolaudim	676,960
Riforcimi pallateve me kod gis: 7330, 5630, 851, 7294, 5541, 60069, 7314, 117, 5638	508,845,578
Mbikqyrje	6,509,343
Kolaudim	606,009
TOTALI	2,303,173,480



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS


Nr. 504 prot.

Durrës, më 17 06 .2022

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS**



Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.62 datë 16.06.2022 Për miratimin e ndryshimit të tabelës së detajimit të fondit, bashkëlidhur VKB Nr 40 dt 09.05.2022 “Për miratimin e detajimit të fondit prej 2.303.173.480 lekë pa TVSH në zbatim të VKM Nr 181 dt 30.03.2022 “Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rforcimit të njësisve individuale të banimit në ndërtesa (pallat), në Bashkitë Tiranë, Durrës, Shijak, Lezhë dhe Krujë” për shkak të një gabimi material.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILJAN JANI

